



Kuvendi i Komunës Kaçanikut

- Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zvillimit -

***Buxheti Afatmesëm i Komunës
për periudhën e viteve 2013-2015***

I. Zhvillimi i aktiviteteve sipas kalendarit kohor në përgatitjen e draft BK për periudhën afatmesme 2013-2015, me theks të veçant për vitin 2013.

- Me këtë proces është filluar që nga muaji 05/2012 me përgatitjen e QBB nr.2013/01 – Përgatitja e Rishikimit të Prioriteteve për BAK 2013-15 - (Janë përcaktuar 6 prioritete të nivelit të lartë),
- Hartimi dhe aprovimi i KAShK-së për vitet 2013-15 (në seancën e 7-të KK, më 31.07.2012),
- QBB nr.2013/02 – Përcaktimi i kufijve specifik të PB dhe nën-PB sipas kufijëve fillestar të Granteve të përcaktuara nga KG dhe MF dhe THVK të parashikuara nga Komuna,
- Mbajtja e seancave të veçanta konsultative me bartësit PB,
- Takimi i përbashkët i EK dhe anëtarëve KPF-së, më 30.08.2012, i organizuar nga OSBE-ja,
- (02) Dëgjimet Buxhetor me qytetarët – të mbajtura më 10.07.2012 dhe 26.09.2012

II. PLANIFIKIMI I TË HYRAVE BUXHETORE 2013-2015


1. Parashikimet për vitin 2013 dhe projeksionet indikative për vitet 2014-2015

- Të hyrat buxhetore (THB) të komunës për vitin 2013 janë në masë monetare prej 5,611,059€, në strukturën e Fondit e përgjithshëm të buxheteve komunale (375,516,600 €), shënojnë pjesmarrje me 1,51%,
- Në strukturë BK për vitin 2013, sikundër edhe për vitet 2014-2015, kemi në vazhdimësi pjesmarrjen dominante të GQ në raport me sigurimin e mjeteve nga THVK – 89,3%:10,7% (GQ=5,011.059 € dhe THVK-600,000 €),
- Analizuar historikun e THB sipas viteve, nga viti 2010 kur kishim një buxhet prej 4,464,273 €, me parashikimet e vitit 2013 do të kemi një rritje të buxhetit prej 25,7%, ndërsa me projeksionet indikative në fund të vitit 2015, do të shënojmë trende të rritjes për 29,3% apo një rritje për afër 1/3 në raport me buxhetin që e shpenzuam në vitin 2010.

2. Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2010 - 2015:

Viti		Granti Qeveritar	THVK	Gjithësejt:
Realizim	2010	3,948,928	515,345	4,464,275
Realizimi	2011	4,935,666	509,847	5445514
Buxheti	2012	4,864,625	593,130	5,457,755
Parashikimi	2013	5,011,059	600,000	5,611,059
Vlerësimet	2014	5,103,705	613,289	5,716,994
Vlerësimet	2015	5,155,669	616,039	5,771,708

2.1. Diagrami i të hyrave të përgjithshme buxhetore për vitet 2010-2015



2.2. Norma (shkalla) mesatare vjetore e rritjës së të hyrave të përgjithshme buxhetore për 2013-2015


Sipas këtyre të dhënave të prezantuara në Pasqyrën Tabelare dhe në Diagram, ku pasqyruam realizimin buxhetor për dy vitet 2010-2011, Buxhetin e komunës të planifikuar për vitin aktual 2012, si dhe parashikimet 2013 me vlerësimet për dy (02) vitet e ardhshme 2014-2015, mund të konstatohet se:

*Buxheti i Komunës (BK) bazuar në këto krahasime analitike, parashikohet që të ketë trende të rritjesë sipas normës mesatare prej 5,9% në vit dhe atë shikuar sipas burimit të mjeteve: Granti Qeveritar me normën mesatare vjetore prej 6,1% dhe THVK-të me normë mesatare prej 3,9% në vitë.*

3. Ndarja sektoriale e mjeteve buxhetore për vitet 2013-2015

Nr.	Sektorët	Buxheti 2013	Struktura në (%)	Nr. Stafit
01.	Admin.Komunale	1,906,414	34,0%	108
02.	Arsimi dhe Kultura	2,985,652	53,2%	573
03.	Shëndetësia dhe MS	718,993	12,8%	115
	Totali i Shpenz. :	5,611,059	100,0%	796


Diagrami i Buxhetit sektorial për vitin 2013




4. Ndarja buxhetore sipas KESH për vitet 2013-2015

Nr.	KESH	Buxheti 2013	Projeksionet 2014	Projeksionet 2015
1.	Pagat dhe Mëditjet	3,743,672	3,743,672	3,743,672
2.	Mallërat dhe Shërb.	535,468	535,468	535,468
3.	Shërbimet Komunale	108,757	108,757	108,757
4.	Subv.dhe Transferet	130,000	130,000	130,000
5.	Investimet Kapitale	1,093,162	1,199,088	1,253,811
	Totali (1 deri 5):	5,611,059	5,716,985	5,771,708

Diagrami i Ndarjës buxhetore sipas KESH për vitet 2013-2015



Diagrami – Struktura e buxhetit sipas KESH, në vitin 2013



III. PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP-it) PËR PERIUDHËN E VITEVE 2013-2015

- Në përpilimin e Listës së Projekteve kapitale për vitet 2013-2015, jemi bazuar në PZHK, në gjashtë (06) prioritetet e larta të Komunës, në nevojat dhe kërkesat direkte të parashtruara nga qytetarët dhe nga bartësit e PB / Drejtorët e EK,
- Me politikat vijuese për tri (03) vitet e ardhshme, Investimet Kapitale parashikohet të shenojnë rritje të vazhdueshme prej vitit në vitë dhe do të jenë të orientuara në realizimin e tyre sipas Listës së projekteve prioritare të miratuara në KK-së, në përputhje me buxhetimet vjetore,
- Me Draft – Buxhetin e Komunës 2013-2015, janë përfshirë (58) projekte në shumë totale prej 3,546,061 € (ky parashikim është i bazuar vetëm në potencialin buxhetor të Komunës, pa i përfshirë Grantet nga ministritë e linjës dhe Donacionet e pritura nga donatorët, të cilat mund të ndodhin gjatë tri (03) viteve të ardhshme buxhetore,
- Bzuar në Listën e përpiluar të PIP-it, vërehet se edhe mëtej vazhdohet me dominimin e projekteve në ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale ku për vitet 2013-2015. i kemi të përfshirë (22) projekte me një kosto financiare prej mëse 1,001,090 €, ndërsa

☞ vetëm për vitin 2013 – kemi (21) sish në vlerë totale prej 456,000 €, me një pjesmarrje strukturale prej 41,7% në totalin e investimeve të parashikuara në nivel të komunës,

☐ Po ashtu, për vitin 2013, përveç investimeve në rrugët lokale, duhet t'i veçojmë edhe disa projekte të tjera nga Infrastruktura Publike, si

- ❖ vazhdimin e punimeve të Varrezat e Dëshmorëve dhe të Varrezat e qytetit 60,000 €
- ❖ Ndërtimi i kanaliz.fekale dhe atmosferike..... 45,000 €
- ❖ Renovimet në (04) objektet publike 55,000 €

☐ Pastaj, kemi edhe projekte tjera të veçanta në 2013,

- ❖ Projektet zhvillimore për bujqësi, blegëtori dhe pylltari, ku për çdo vitë janë parashikuar nga 55,000 €, ndaras nga kjo shumë kemi edhe subvencionimi i fermerëve komunal i prashikuar për (03) vite radhazi me nga 45,000 €, si dhe
- ❖ Shuma në dispozicion prej 130,362 € (totali 2013-2015 prej 427,062 €), mjetet këto për bashkëfinancim në realizimin projekteve të përbashkët me ministritë e vendit dhe donatorët),

IV. Konkluzionet Përmbyllëse:

- ❑ Përgatitjes dhe hartimit të draft – Buxhetit të Komunës për vitet 2013 – 2015, në të gjitha fazat e zhvilluara iu është dhënë përkushtim i merituar, e mbi të gjitha rëndësi të posaçme: ndarjes së drejtë të mjeteve buxhetore sipas PB dhe nën PB, strukturimit të shpenzimeve sipas KE, respektimit të prioritetëve sektoriale dhe ruajtjes së stabilitetit fiskal e buxhetor,
- ❑ Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të Prillit 2011, do të zbatohen nga viti 2014 (prej vitit 2003-2013 në aplikimin e formulës në ndarjen e Granteve nga Qeveria është marrë për bazë numri i popullsisë së Komunës për 33,000 banorë, kurse prej vitit 2014 – 33,409 banorë),
- ❑ Sipas Programit të Qeverisë të harmonizuar me FMN-në, profili i strukturës së shpenzimeve sipas KE, duke filluar nga viti 2013 iu është lejuar komunave fleksibilitet pa ndonjë përkufizim në planifikimin e shpenzimeve nga THVK, përpos KE te Pagat dhe Mëditjet,

- ❑ Buxhetimi në nivel shkollave me shtrirjen e autonomisë financiare. Komuna e ka bërë delegimin e buxhetit në shkolla sipas nenit 9. paragrafi 3.1. të Ligjit për Arsim Parauniversitar, duke përgatitur buxhetet e tyre për ekzekutim sipas rekomandimeve të marrura nga MASHT-i, MF-ja dhe MAP-i,
- ❑ Me vendim të KG të bazuar në LFPL, Komuna nga GP dhe THVK ka financuar dhe ndihmuar me mjete buxhetore DAK-in dhe DSHMS në shumë totale **531,854 €** (nga GP- 424,304 € dhe THVK- 107,550 €):
 - DAK-in me **456,268 €** dhe atë: nga GP shumën prej 365,212 € dhe nga THVK shumën prej 91,050 € (financim i drejtorisë 152,249 € dhe ndihmë me mjete shtesë shkollave dhe për Invest.Kapitale shuma 304,019 €),
 - DSHMS-ja së bashku me QPS-në janë financuar dhe ndihmuar me mjete shtesë në total prej **75,586 €** dhe atë nga GP shumën prej 59,086 € dhe nga THVK shumën prej 16,500 € (Drejtoria me 21,900 € dhe QPS-ja me 53,686 €),
- ❑ Zvoglimi i stafit dhe masës monetare të buxhetit me rastin e transfer. të SHZF dhe IT në menaxhim të MPB dhe MTI-së (stafi për 18 + 1 = 19 punëtorë dhe buxheti përcjellës për 103,540 + 4,486 = 108,026 €),

- ❑ Planifikimi i buxhetit për Shërbime Sociale për 2013-2015 sipas Projektit të DFID-it, duke u bazuar në prioritet e përcaktuara nga grumbullimi i informatave adekuate dhe kalkulimi i kostove për njësi (me decentralizimin e vazhdueshëm të SHS, QPS-ja do të ushtroj kompetencat dhe rolin funksional në rrafshin komunal.
SHS të kalkuluar sipas viteve: 2013 - 136,800 €, 2014 - 169,200 €
dhe 2015 - 205,000 €
- ❑ Përfshirja e Bilanceve të Pahpenzuara nga viti 2012 (THVK të inkasuara nga M=11-12/2012 dhe mbetjet eventuale në KESH), dhe intervenimet tjera nga Qeveria e Vendit
- ❑ Projektet Kapitale janë bazuar në (6) prioritetet e Komunës,
- ❑ (13) projekte vetëm per Kodim (me nga 5,000 euro), në shumë prej 65,000 €,
- ❑ Përpunimi i të gjitha të dhënave në Sistemin unik të BDMS-së dhe PIP-it